



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

DOKUMENT I SHKURTËR I POLITIKAVE

# PA RRUGËDALJE?

## Vlerësim i bashkëpunimit policor në mes Kosovës dhe Serbisë

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Autore: Sofije Kryeziu

Redaktimi i brendshëm: Florian Qehaja

Recensent: Shpend Kursani

Nëntor 2016

©Të gjitha të drejtat e rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronësisë intelektuale mbrohen me ligjin nr. 2011/04-L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike, apo të transmetohet në ndonjë formë ose mjet elektronik, mekanik ose formë tjetër pa lejen paraprake të botuesit.

Ky botim është përkrahur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Të gjitha pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm të Qendrës Kosovare për Studimet të Sigurisë dhe të autorit, dhe nuk i paraqesin ato të KFOS-it apo të partnerëve të tjerë të QKSS-s.

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave.....	4
Gjetjet kryesore.....	5
Hyrje.....	6
Përpyqjet e Kosovës për bashkëpunim bilateral .....	6
Rreziqet dhe kërcënimet ndërkufitare .....	8
Lehtësim ose pengim?.....	9
Problemet kryesore: mungesa e demarkacionit dhe militarizimi i kufirit .....	11
Rekomandime .....	13
Bibliografia.....	14

## Lista e shkurtesave

<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>EULEX</b>	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
<b>Europol</b>	Zyra e Policisë Evropiane
<b>MIK</b>	Menaxhimi i integruar i kufirit
<b>ILECU</b>	Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në fushën e Zbatimit të Ligjit
<b>Interpol</b>	Organizata Ndërkombëtare e Policisë kundër Krimin
<b>KFOR</b>	Forcat e Kosovës (Forcë paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga Organizata e Traktatit Veri-Atlantik)
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>MPJ</b>	Ministria e Punëve të Jashtme
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MUP</b>	Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë (Ministarstvo Unutrašnjih Poslova)
<b>ZQK</b>	Zyra Qendrore Kombëtare
<b>QKMK</b>	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
<b>MSA</b>	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit
<b>PSA</b>	Procesi i Stabilizim-Asocimit
<b>EJL</b>	Evropa Juglindore
<b>UNMIK</b>	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
<b>UNOCD</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin
<b>BP</b>	Ballkani Perëndimor

## Gjetjet kryesore

- Të tri palët - BE-ja, Kosova dhe Serbia, nuk kanë një strategji të qartë se si ta forcojnë dhe ta bëjnë zyrtare bashkëpunimin bilateral policor. Serbia veçmas nuk ka vullnet politik të themelojë bashkëpunim bilateral me Kosovën përkundër kërkesave të BE-s që ajo të nis bashkëpunimin policor me Kosovën sikurse me vendet e tjera fqinje.
- Bashkëpunimi bilateral policor mes Kosovës dhe Serbisë fokusohet kryesisht në “politikën e larta”, sa që organizatat tërësisht profesionale duhet të mbështeten në direktivat e politikës. Ky kontekst e lë në hije sigurinë si një e mirë e përbashkët dhe publike.
- Krimi trans-nacional dhe rreziqet e kërcënimit e tjera ndërkufitare po ndihmohen edhe falë mungesës së këtij bashkëpunimi. Veprimtaria kriminale është tejet e pranishme në kufijtë e të dyja vendeve, si dhe në pjesën veriore të Kosovës.
- Edhe pse UNMIK-u dhe EULEX-i po e ndihmojnë komunikimin mes dy palëve, megjithatë ka tregues të fortë që Kosova po lihet anash dhe se merr informata tejet të kufizuara policore, qoftë nga Serbia apo edhe nga vendet e tjera që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës.

Tash për tash, komunikimi i drejtpërdrejtë mes dy forcave policore - edhe pse i kufizuar - është jo formal dhe rëndom bëhet përmes thirrjeve telefonike. Kjo krijon pengesa të mëdha për shkëmbimin e informatave inteligjente me dobi për të dyja palët.

- “Militarizimi” i kufirit mes Kosovës dhe Serbisë vërehet me praninë e ushtrisë së Serbisë. Si rrjedhojë, kjo është zona e fundit kufitare “e militarizuar” në Ballkanin perëndimor. Prania e ushtarëve nuk manifeston vetëm frikë për qytetarët që jetojnë në zonat kufitare, por është edhe kundër konceptit të BE-s për siguri kufitare në të cilin theksohet nevoja e forcave policore për t’i vëzhguar kufijtë.
- “Marrëveshja e fusnotës” e nënshkruar mes Kosovës dhe Serbisë, e cila synonte t’i parandalonte pengesat e përfaqësimit rajonal dhe ndërkombëtar, nuk është respektuar krejtësisht nga Serbia. Për më tepër, Serbia ka vazhduar ta pengojë Kosovën ose drejtpërdrejt, duke e vështirësuar pjesëmarrjen e Kosovës në nismat rajonale të sigurisë, ose tërthorazi, duke e shfrytëzuar pozitën e saj (të forcuar së fundmi) ndërkombëtare dhe mjetet e tjera për të ndikuar te vendet e ndryshme që ta kundërshtojnë rrugën e Kosovës drejt një përfaqësimi të barabartë.

## Hyrje

Vendet që aspirojnë anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE) duhet të kenë marrëdhënie të mira fqinjësore. Marrëdhëniet e shëndosha ndërshtetërore kontribuojnë drejt përmirësimit të sigurisë dhe bashkëpunimit rajonal. Në kontekstin e Ballkanit perëndimor, bashkëpunimi policor konsiderohet si një ndër aspektet më të rëndësishme meqë i shërben paqes dhe stabilitetit. Andaj, anëtarësimi në BE është i kushtëzuar, mes të tjerash, edhe me përmirësimin e bashkëpunimit multilateral dhe bilateral. Përparimi në këtë drejtim matet përmes mekanizmave të ndryshëm që janë përcaktuar nga BE-ja dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare. Edhe pse, në përgjithësi, ka pasur një avancim në bashkëpunimin bilateral dhe multilateral përmes nis-mave rajonale, prapë se prapë ka mbetur një hendek i madh në këtë drejtim për shkak të bashkëpunimit të kufizuar në fushën e sigurisë mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo gjendje vjen kryesisht prej faktorëve politik, pra refuzimit të Serbisë që ta njohë Kosovën, dhe prej veprimeve që i merr për ta penguar përfaqësimin e saj në sistemin ndërkombëtar. Kjo bëhet në kundërshtim me marrëveshjet e arritura, dhe e lë në hije mundësinë e bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Për më tepër, kundërshtimi i vazhdueshëm që ta njeh zyrtarisht Kosovën si një shtet sovran nuk duhet të shërbejë si pengesë në bashkëpunimin policor meqë kjo është në të mirën e të dyja vendeve dhe të të dy popujve.

Marrëveshjet bilaterale dhe shkëmbimi i informatave janë prej formave më të vjetra dhe më efektive të bashkëpunimit policor dhe në fushën e gjyqësisë (Greene 2007). Marrëveshjet e tilla bilaterale bëhen me qëllim të themelimit të bashkëpunimit ndërkufitar, duke krijuar mundësi ligjore për shkëmbim të informatave. Marrëveshjet formale bilaterale në fushën e policisë realizohen kryesisht mes vendeve që kanë besim në njëra-tjetrën, duke treguar shenja të besimit reciprok në çështjet policore (ibid). Në dritën e hulumtimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit policor, si një e mirë e ndërsjellë në kontekstin Kosovë-Serbi, gjejmë se i vetmi shembull pozitiv është ai i marrëveshjes së me-

naxhimit të integruar të kufirit (MIK),<sup>1</sup> e cila qe mundësuar me ndërmjetësimin e BE-s. Kjo marrëveshje, megjithatë, pengohet për shkak të mungesës së komunikimit me institucionet e tjera, d.m.th. policisë, gjë që përbën një pengesë të jashtëzakonshme në zbatimin e parimeve bazë të MIK-ut. Komunikimi i kufizuar mes dy palëve ndërmjetësohet nga prania ndërkombëtare në Kosovë, duke krijuar kufizime kur kemi të bëjmë me shkëmbimin e informatave inteligjente.

Ky raport merret me analizimin e bashkëpunimit të kufizuar dhe të ndërmjetësuar mes Kosovës dhe Serbisë. Qëllimi parësor i tij është që ta ngrejë zërin për një bashkëpunim të plotë, duke e pasur në mendje natyrën e përbashkët të sfidave ndërkufitare dhe kushtëzimin e BE-së, posaçërisht për Serbinë. Të dhënat për këtë raport janë mbledhur kryesisht përmes analizimit të materialeve të ndryshme, analizimit të bazës së gjerë ligjore, të raporteve dhe të artikujve të ndryshëm vendor, rajonal dhe ndërkombëtar. Po ashtu, janë realizuar një varg intervistash në terren me persona kyç. Personat e intervistuar ishin kryesisht përfaqësues të institucioneve të Kosovës, të Policisë së Kosovës dhe të misioneve ndërkombëtare të pranishme në Kosovë. Ka qenë e vështirë qasja në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, gjersa edhe më i vështirë ishte komunikimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Serbisë.

## Përpjekjet e Kosovës për bashkëpunim bilateral

Për shkak të statusit të kontestuar të Kosovës, institucionet e saj të dala pas pavarësisë nuk u bënë trashëgimtarë të institucioneve veçse të themeluara nga UNMIK-u. Deri vonë, Kosova përfaqësohej nga prania ndërkombëtare në Kosovë, ose nga UNMIK-u në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar, ose nga ELUEX-i, mes tjerash, në nivel bilateral [me Serbinë]. Kjo bëhej kryesisht për shkak të pengesave për ta pranuar

<sup>1</sup> Marrëveshja e MIK u arrit më 2 dhjetor 2011 me qëllim të krijimit të një pike kufitare të përbashkët të integruar, dhe të sigurt, e cila do të përcaktohej bashkërisht dhe ku zyrtarët e secilës palë do t'i kryenin kontrollat përkatëse. Vjegëza: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_ibm.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_ibm.pdf), vizituar më 10.05.2016

pjesëmarrjen e Kosovës në sistemin rajonal dhe ndër-kombëtar, të cilat bëheshin nga Serbia dhe vendet e tjera që nuk e njihnin Kosovën. Që prej shpalljes së pavarësisë së saj në shkurt të vitit 2008, Kosova ka arritur të themelojë marrëdhënie bilaterale dhe multilaterale me shtetet e tjera dhe me organizata ndërkombëtare. Megjithatë, kjo ka dalë të jetë mjaft sfiduese, posaçërisht kur e krahasojmë me shtete të tjera që njihen në nivel ndërkombëtar. Kosova ka arritur një përparim të kufizuar në fushën e bashkëpunimit të sigurisë rajonale dhe të bashkëpunimit policor me vendet e Ballkanit perëndimor. Në këtë kontekst, Kosova ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit policor me tri shtetet e saj fqinje. Prej vitit 2009 janë nënshkruar tri marrëveshje të bashkëpunimit policor. Dy prej tyre u nënshkruan në fund të vitit 2009 me Shqipërinë dhe Maqedoninë, dhe tjetra, pesë vjet më vonë (në vitin 2014), u nënshkrua me Malin e Zi në fushën e bashkëpunimit policor.

Para nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve u pat nënshkruar edhe një marrëveshje e bashkëpunimit policor me shtetin tjetër fqinj Serbinë. Kjo ishte marrëveshja e parë në fushën e sundimit të ligjit, dhe njihet si **Protokolli i bashkëpunimit policor mes EULEX-it dhe MUP-it** si parakusht për liberalizimin e regjimit të vizave për Serbinë. Protokolli u nënshkrua prej të dy palëve më 11 shtator 2009, dhe përbën një marrëveshje teknike për bashkëpunimin policor mes Kosovës dhe Serbisë, por që e lë Kosovën jashtë procesit. Marrëveshja, edhe pse nuk është publike, përmban dispozita të bashkëpunimit policor dhe të shkëmbimit të informatave për ta luftuar krimin e organizuar ndërkufitar dhe të veprimtarive të tjera të jashtëligjshme, si trafikimi i njerëzve, substancave narkotike, armëve në kufirin mes Kosovës dhe Serbisë (The Protocol: EULEX, MUP, and Kosovo). Bashkëpunimi me vendet e tjera fqinje (me Shqipërinë, Malin e Zi, dhe Maqedoninë) është i konsoliduar, dhe Kosova realizon patrullime të rregullta të përbashkëta policore në kufi me këto vende. Ngjashëm, edhe Serbia realizon patrullime të tilla të përbashkëta me Bullgarinë, Kroacinë, Hungarinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Rumaninë, por jo edhe me Kosovën.

BE-ja këmbëngul vazhdimisht për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, duke përf-

shirë edhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura gjatë dialogut mes të dy vendeve. Normalizimi i marrëdhënieve mes dy vendeve vihet në pah në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja. Marrëveshja e parë ishte: "Parimet qeverisëse për normalizim të marrëdhënieve", e njohur edhe si Marrëveshja e Brukselit që u arrit në prill të vitit 2013. Megjithatë, Kosova është pala e vetme që e ka ratifikuar këtë dokument me dy të tretat e shumicës në Kuvend. Serbia, në anën tjetër, e ka anashkaluar ratifikimin e Marrëveshjes së Brukselit me Prishtinën, duke e pranuar raportin e qeverisë për procesin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura (Parlamenti i Serbisë, 2013).

Në shkurt të vitit 2012 këto dy vende e arritën "Marrëveshjen e fusnotës", e cila kishte për synim ta përmirësonte përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal. Të dyja palët e konfirmuan përkushtimin ndaj vlerave themelore të BE-së për një bashkëpunimi efektiv, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues rajonal (Marrëveshja për bashkëpunimin rajonal dhe protokollin teknik i MIK). "Marrëveshja e fusnotës" konsiderohet si një konsensus mes Kosovës dhe Serbisë, ku kjo e fundit nuk do ta pengonte përfaqësimin apo anëtarësimin e Kosovës në organizatat rajonale. Në anën tjetër, për Kosovën u përfshi një fusnotë në emrin e saj, ku lexohej "**Ky emërtim nuk e prejudikon qëndrimin për statusin, dhe është në përputhje me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit dhe me mendimin e GjND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës**" (Marrëveshja për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal). Megjithatë, përkundër kësaj marrëveshje, Serbia vazhdon ta pengojë Kosovën ose drejtpërdrejtë, duke e penguar pjesëmarrjen e Kosovës në nismat rajonale të sigurisë, ose tërthorazi, duke e përdorur pozitën e saj ndërkombëtare (të forcuar kohëve të fundit) si formë për të ndikuar te vendet e tjera që e kundërshtojnë rrugëtimin e Kosovës drejt përfaqësimit të barabartë. Serbia e ka shfrytëzuar secilën mundësi dhe secilin takim për të folur kundër njohjes së Kosovës dhe të pjesëmarrjes e anëtarësimit të saj të plotë në nismat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare.

## Reziqet dhe kërcënimet ndërkufitare

Ashtu sikurse vendet e tjera në rajon, edhe Kosova dhe Serbia përballen me vështirësi të ngjashme të sigurisë dhe me rreziqe e kërcënime ndërkufitare. Nuk realizohen patrullime të përbashkëta mes dy shteteve gjatë vijave të tyre kufitare. Dimensioni i sigurisë së njerëzve është përjashtuar, ndërsa vëmendja është përqendruar në politikat e nivelit të lartë, pa e marrë parasysh ndikimin negativ në jetën e përditshme të qytetarëve. Kjo gjendje vazhdon e këitillë meqë Serbia e konsideron policinë si një institucion që e përfaqëson shtetësinë e Kosovës, kurse Kosova bënë përpjekje që të gjejë një mënyrë për ta tejkaluar këtë problem. Kjo vërehet posaçërisht në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë nuk e paraqet një zonë kufitare, pjesa veriore e Kosovës është e banuar kryesisht nga serbë kosovarë, dhe prej shumë raporteve ndërkombëtare konsiderohet si strehë e krimit të organizuar, kontrabandës, dhe të tregut të zi dhe jo formal për shkak të ndikimit të vazhdueshëm të Beogradit në këtë pjesë të vendit. Grupet kriminale duket se nuk njohin paragjykitime etnike kur shohin mundësi afariste dhe përfitime ekonomike në zona të brishta kufitare (KE 2015). Veriu i Kosovës paraqet një mundësi për shkak se kontestet kanë krijuar një vakum të kontrollit dhe të autoritetit (Duraku 2016).

Ka mungesë të shkëmbimit të informatave për lëvizjet kufitare që e bënë më të lehtë punën e grupeve të organizuara kriminale. Për shkak të mungesës së bashkëpunimit policor, identifikimi i kriminelëve është i kufizuar, gjë e cila e zgjeron shkallën e rrezikut dhe të kërcënimeve në nivel rajonale, pra në tërë vendet e Ballkanit perëndimor, dhe veçanërisht mes Kosovës dhe Serbisë. Mungesa e bashkëpunimit bilateral policor mes dy vendeve ka mundësuar dhe e ka bërë të lehtë, deri më tani, zhvillimin e veprimtarive të paligjshme, siç janë: **trafikimi i drogave**, ku rajoni i Ballkanit është shtegu kryesor i trafikimit të drogave nga lindja në perëndim. Kjo rrugë e shpërndarjes së drogës nga Afganistani në vendet evropiane, përmes vendeve të Ballkanit perëndimor, njihet si rruga e Ballkanit (UNO-DC 2015). Rruga e Ballkanit nis prej Afganistanit e deri te Republika Islamike e Iranit dhe e Turqisë, duke e për-

shkuar edhe vet Ballkanin, dhe konsiderohet si rruga më e rëndësishme e shpërndarjes së heroinës (UNO-DC 2014). E ashtuquajtura dega perëndimore, apo rruga e Ballkanit, është ajo e cila kalon përmes vendeve të Ballkanit perëndimor dhe e prek si trajektoren detare ashtu edhe atë tokësore për të arritur në Evropë (UNO-DC 2010). Dega perëndimore nuk aplikohet barabartë për të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor. Kryesisht rezervohet për Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë, si dhe vazhdon deri në vendet e Bashkimit Evropian (EMCDDA and Europol 2016).

Një problem i ngjashëm është edhe ai i **prerjeve ilegale të druve** - janë paraqitur probleme serioze me tri raste të prerjes së druve në zonën kufitare, duke shkaktuar dëme kolaterale për të dyja vendet (Kursani 2015). Dëmet ekonomike janë të mëdha në rajonin e Podujevës dhe Leposaviqit, posaçërisht në zonat kufitare (Twelmeier 2016). Edhe Policia e Kosovës edhe ajo e Serbisë kanë informacione dhe të dhëna personale për personat që janë të përfshirë në veprimtari kriminale, porse ato mbesin vetëm si fakte meqë ka dështime në nivelin operativ për shkak të mungesës së bashkëpunimit në kufi. Kur flasim nga aspekti operativ, të dyja palët kanë informata, dhe teknikisht do të mund t'i realizonin me lehtësi veprimet policore (Ibid 2016). Sipas Agjencisë së Pyjeve të Kosovës, 42 për qind e Kosovës është e mbuluar me pyje; ndërsa 35 për qind e kësaj toke pyjore prehet në mënyrë të pakontrolluar. Sa i përket vëllimit të humbjes së druve përmes kësaj veprimtarie të paligjshme del se 100,000 m<sup>3</sup> dru humbin për çdo vit (NFG 2012). Kjo praktikë zhvillohet më shumë në zonat kufitare, që janë cak i hajdutëve. Për më tepër, në vitin 2014 mungesa e bashkëpunimit mes autoriteteve policore në parandalimin e prerjeve të paligjshme rezultoi në një përplasje të armatosur mes xhandarmërisë dhe qytetarëve shqiptarë afër pikës kufitare të Merdares, duke përfunduar me dy viktima dhe një të plagosur (Blic 2014). Së fundmi, **kontrabanda e emigrantëve** është bërë një dukuri e njohur. Migrimi i paligjshëm i qytetarëve të Kosovës që udhëtojnë drejt BE-s është rritur dukshëm kah fundi i vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015. Kjo duket se ka ardhur si rezultat i rrjeteve kriminale të kontrabandistëve që veprojnë në Kosovë dhe Serbi, dhe të cilët i kanë shfrytëzuar rrugët ilegale përmes Serbisë për dërgimin e emigrantëve në BE (Avdiu 2015). Vlerë-



simet tregojnë se ishin rreth 135,000 kërkesa për azil të qytetarëve kosovarë në periudhën nga viti 2012 deri në pjesën e parë të vitit 2015 (SOCTA 2016). Emigrimi i paligjshëm e ka vënë në pah mungesën e bashkëpunimit mes dy institucioneve të zbatimit të ligjit, dhe në veçanti të policisë. Mungesa e bashkëpunimit policor bilateral për këto çështje tejet serioze të sigurisë e pengon edhe parandalimin e suksesshëm të veprimtarive të paligjshme trans-nacionale.

## Lehtësim ose pengim?

Komunikimi zyrtar mes Policisë së Kosovës dhe Policisë së Serbisë/MUP është kryesisht i tërthortë. Çfarëdo komunikimi zyrtar moderohet prej (e drejtë e rezervuar) pranisë ndërkombëtare në Kosovë, si nga UNMIK-u ashtu edhe nga ELUEX-i. Në një vështrim më të gjerë, nga perspektiva multilaterale, Kosova nuk është pjesë e organizatës më të mëdha policore ndërkombëtare - INTERPOL-it. Arsyeja kryesore e mos përfaqësimit të Kosovës në këtë organizatë është politike, kryesisht për shkak të mosnjohjeve ndërkombëtare. Së këndejmi, bashkësia ndërkombëtare e pranishme tani në Kosovë është ende përgjegjëse për komunikimin e drejtpërdrejtë me INTERPOL-in dhe me vendet e tjera që nuk e kanë njohur Kosovën, siç është Serbia. Meqë Kosova nuk mund të ketë një organ parimor për shkëmbimin e informatave, pra të një Zyre Qendrore Kombëtare (ZQK), në kuadër të INTERPOL-it, si rrjedhojë UNMIK-u është bërë nikoqir i ZQK-së. ZQK-të janë pika kontakti të shteteve anëtare në kuadër të rrjetit global të INTERPOL-it, dhe kontribuojnë në bazën e të dhënave kriminale dhe bashkëpunojnë në hetimet ndërkufitare, operacionet dhe arrestimet (INTERPOL - NCB 2016). Për këtë qëllim, në vitin 2002 INTERPOL-i dhe UNMIK-u e nënshkruan një Memorandum të mirëkuptimit për bashkëpunim në parandalimin e krimit dhe në fushën e drejtësisë penale. Përveç parandalimit të krimit dhe bashkëpunimit në fushën e drejtësisë penale, neni një i memorandumit e përfshinë shkëmbimin e informatave policore, transmetimin, shpërndarjen dhe qasjen në rrjetin dhe bazën e të dhënave të Interpol-it (MoU Interpol & UNMIK). Sa i përket shkëmbimit të informatave dhe marrëveshjeve të tjera të bashkëpunimit të parapara

në memorandum, UNMIK-u i ka të drejtat e njëjta si ato që i kanë edhe shtetet anëtare dhe zyrat qendrore kombëtare (neni 4, MoU Interpol & UNMIK). Së këndejmi, dhe meqë Kosova nuk mund të jetë nikoqire e një ZQK-je, ajo është e kufizuar kur bie fjala të komunikimi me Serbinë për çfarëdo krimi me të cilin merret INTERPOL-i, edhe nëse ato kanë të bëjnë me çështje që ndikojnë drejtpërdrejt te të dyja shtetet. Kosova është e kufizuar në marrjen e informatave policore nga INTERPOL-i, dhe në ato raste kur PK-ja e pranon ndonjë informatë policore, ato janë të paplota. Për shembull, nëse UNMIK-u e pranon një faqe ose dy të informatave policore përmes INTERPOL-it, shpesh vendos që ta shkëmbejë me PK-në vetëm një paragraf me arsye-timin se Kosova është palë e tretë, kështu që varet prej palës së parë të vendos se sa informacion dëshiron ta shkëmbejë me një palë të tretë (Elshani 2016). Në të vërtetë, kjo çështje është e rregulluar me **regullat për përpunimin e të dhënave të INTERPOL-it**, ku neni 60, paragrafi 2, thekson se kur një palë e tretë kërkon qasje në informata që janë në bazën e të dhënave të policisë, atëherë sekretariati i përgjithshëm në kuadër të INTERPOL-it mund t'ia dërgojë ato të dhëna vetëm pasi ta ketë marrë paraprakisht autorizimin e qartë nga vet burimi i atyre të dhënave. Po kështu, neni 58 thekson se secila ZQK mund të vendos kufizime të qasjes për ZQK-të e tjera, subjektet ndërkombëtare ose subjektet private, për të dhënat që i ka futur në bazën e të dhënave të policisë. Për më tepër, mesazhet janë të kufizuara vetëm për pranuesit fillestar, përveç nëse specifikohet ndryshe nga zyra apo subjekti në fjalë.

Kjo gjendje e ka përjashtuar Kosovën dhe nuk kontribuon pozitivisht në parandalimin e suksesshëm të krimit trans-nacional dhe të bashkëpunimit për çështje policore. Në këtë drejtim, Kosova ka probleme serioze me pronësinë e informatave. Mos qenia anëtare e INTERPOL-it ia kufizon mundësitë Kosovës që të jetë pronare e informatave dhe, si rrjedhojë, dalin një varg problemesh që ndikojnë në shkëmbimin e informatave sa i përket shpejtësisë, cilësisë dhe sasisë së tyre (Elshani 2016). Pronësia do t'i rezervonte më shumë përgjegjësi Kosovës, dhe do ta bënte më llogaridhënëse. Për më tepër, ka rënë bashkëpunimi mes UNMIK-ut dhe PK-së. Në ZQK-në e UNMIK-ut punonin 12 persona, ku vetëm njëri ishte punëtor vendor. Meg-

jithëkëtë, në fund të vitit 2015, PK-ja e ka tërhequr zyrtarin e vet nga UNMIK-u, dhe se zyrtarët e MPB-së dhe të MD-së nuk lejoheshin të merrnin pjesë në ngjarjet e organizuara nga UNMIK-u (Twelmeier 2016). Arsyja kryesore për moslejimin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Kosovës bazohej kryesisht në faktin që Kosova nuk përfaqësohej barabartë me vendet e tjera pjesëmarrëse (Mulolli 2016). Tani për tani janë 11 punonjës<sup>2</sup>, ku gjashtë prej tyre janë përfaqësues të EULEX-it (Hoffman 2016).

EULEX-i është organ institucional që bashkëpunon me Serbinë në mënyrë të pavarur edhe për çështje të policisë (Kursani 2015). Përveç bashkëpunimit me INTERPOL-in dhe Europol-in, EULEX-i dhe MUP-i i Serbisë komunikojnë drejtpërdrejt me njëri-tjetrin, dhe përkundër deklaratës së ish-Shefit të Misionin Yves de Kermabon se informatat e pranuar [në kontakt me Serbinë] do të shkëmbehen me autoritetet relevante të Kosovës për të mirën e institucioneve të sundimit të ligjit, megjithatë, realiteti nuk e reflekton atë retorikë (EULEX Head of Mission Statement on Police Protocol 2009). EULEX-i e ka rolin kryesor kur flasim për bashkëpunimin e drejtpërdrejtë bilateral me Serbinë në fushën e policisë. I ka tri nivele të bashkëpunimit/komunikimit me autoritetet e Serbisë. Së pari, Zyra ndërlidhëse e BE-s në Beograd i ka 3-4 zyrtarë politikë me qëllim që të mbajë kontakt më të afërt dhe të drejtpërdrejtë me Beogradin dhe me delegacionin e BE-s në Beograd (Sedar, 2016). Së dyti, komunikimi *polici me polici* është një komunikim i drejtpërdrejtë dhe ndodh në të gjitha nivelet e policisë. Niveli i tretë është komunikimi me *policinë ndërkombëtare*, kanali zyrtar i INTERPOL-it, ku mes çështjeve të tjera UNMIK-u komunikon drejtpërdrejt me INTERPOL-in në Beograd (Hoffman 2016). EULEX-i duket se është caktuar që të bëjë shkëmbimin zyrtar të informatave me autoritetet e Kosovës, që më parë ishin shkëmbyer me Serbinë. Sipas zyrtarëve të lartë në kuadër të EULEX-it, njëra prej sfidave kryesore kur flasim për shkëmbimin e informatave policore është nevoja e shkëmbimit të informatave në mënyrë zyrtare. Kjo veçanërisht ku kanali i komunikimit zhvillohet nga forcat policore të Kosovës dhe Serbisë.

Duke e pasur parasysh se ka sfida të vazhdueshme kur flasim për shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin me Serbinë për çështje policore, dhe përkundër marrëveshjeve të tyre për lehtësimin e procesit, roli i bashkësisë ndërkombëtare është në pikëpyetje. Meqë informatat e shkëmbyera krijojnë pengesa për shfrytëzimin zyrtar të tyre, ato mund ta pengojnë edhe parandalimin e suksesshëm të krimeve të ndryshme. Duket se kanë dështuar që të krijojnë një mekanizëm të qëndrueshëm të bashkëpunimit, dhe nuk kanë arritur të parandalojnë krime të ndryshme mes dy vendeve dhe në rajon. Në anën tjetër, edhe pse EULEX-i dhe UNMIK-u kanë për qëllim të lehtësimin të kontakteve mes Kosovës dhe Serbisë, duke qenë nikoqir të ZQK-së së INTERPOL-it, Europol-it dhe nënshkrimi i marrëveshjeve, ato megjithatë paraqesin pengesa burokratike për komunikimin e tyre të drejtpërdrejtë. Si UNMIK-u, dhe posaçërisht EULEX-i, bashkëpunojnë me Serbinë për çështje policore, që bien në kuadër të bashkëpunimit policor bilateral mes dy shteteve, dhe si të tilla ato kontribuojnë në parandalimin e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë mes dy shteteve. Përveç kësaj, Policia e Kosovës merr informata të kufizuara policore, e në anën tjetër, bashkësia ndërkombëtare është në dijeni për të gjitha informatat që i posedon Policia e Kosovës, ndërsa që vetë Kosova lihet anash në këtë proces. Duke e parë këtë nga perspektiva e posedimit të informatave, del se është tejet e vështirë për Kosovën që t'i parandalojë me sukses një varg veprimtarish kriminale në kufijtë e saj me Serbinë dhe në pjesën veriore të Kosovës, si dhe problemet e tjera të sigurisë që janë në kuadër të çështjeve bilaterale.

Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufirit u arrit në fillim të vitit 2011, dhe u pasua me nënshkrimin e protokollit teknik nga Kosova, ku edhe Serbia e ndërmori të njëjtin hap në fund të atij vitit. Marrëveshja përcakton që të dyja shtetet duhet të instalojnë pika të përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta në të gjitha vendkalimet kufitare (gjithsej gjashtë), të cilat janë përcaktuara bashkërisht me qëllim që ta ushtrojnë bashkëpunim e tyre (IBM 2011). Këto gjashtë pika të përkohshme të kalimit kufitar janë të veçuara barabartë mes dy palëve dhe asnjëra prej palëve nuk do t'i shfaq simbolet e veta në zonën e përbashkët të MIK. Kosova i ka themeluar tri pika

<sup>2</sup> Do të bëhet një shkurtim prej 50 për qind të zyrtarëve të EULEX-it në INTERPOL, tre prej tyre do të mbesin.

kufitare të MIK, ndërsa themelimi i tri pikave të tjera të MIK u vonuan nga Serbia, por u përfunduan vetëm në fillim të vitit 2013. Përveç kësaj, qe arritur marrëveshje për këto gjashtë pika të përkohshme aktuale, duke i përfshirë edhe dy pika shtesë të përhershme në vijën kufitare mes Kosovës dhe Serbisë (EC 2015). Kosova e ka nisur hapjen e një pike të re kufitare, të quajtur Kapia e Sforcës, me Serbinë (Zyra e Kryeministrit 2016). Edhe pse Serbia e ka nisur procesin e shpronësimit në territorin e saj, kalimet e jashtëligjshme në pjesën veriore të Kosovës shfrytëzohen rregullisht për kontrabandën e mallrave (EC 2015). Duke e marrë parasysh qasjen e Serbisë dhe qëndrimin e saj karshi Kosovës, veçanërisht në sektorin e sigurisë, do të kalojë një kohë deri në marrjen e masave konkrete për themelimin e pikave të tjera kufitare. Mbahen takime javore të nivelit lokal mes Kosovës dhe Serbisë në secilën prej gjashtë pikave kufitare, përveç takimeve të rregullta mujore, në kuadër të departamenteve të policisë rajonale, dhe të gjitha lehtësohen nga EULEX-i (Kursani 2015). Temat që diskutohen janë ato që lidhen me vështirësitë e sigurisë ndërkombëtare. Në anën tjetër, por në një nivel më të gjerë, mbahen takime të rregullta në të dyja vendet. Këto takime mbahen një herë në muaj dhe kryesisht lehtësohen prej UNMIK-ut. Në këto takime rëndom marrin pjesë komisione të përbëra prej disa kolonelëve dhe lejtantë kolonelëve, që vijën në Kosovë katër deri gjashtë herë në vit, dhe e njëjta bëhet edhe në Serbi, në Kurshumli (Twelmeier 2016). Temat që zhvillohen mes dy vendeve përfshijnë krimin e organizuar, korrupsionin, luftën kundër terrorizmit dhe problemet me emigrantë (Hoffmann 2016). Këto takime mbahen me qëllim të shkëmbimit të drejtpërdrejtë të informatave sa i përket rasteve kriminale, kërkesave për shkëmbim të të dhënave, si të dhënat personale, dosjet e krimin, etj.

Një formë e drejtpërdrejtë e komunikimit mes autoriteteve të policisë së Kosovës dhe Serbisë bëhet përmes kanaleve jozyrtare të komunikimit. Ky kanal i komunikimit jozyrtar shfrytëzohet për shkëmbimin e informatave kur Kosova ose Serbia përballen me probleme më serioze që e kërcënojnë sigurinë. Kanë bashkëpunuar në mënyrë reciproke për të mirën e secilit në të kaluarën për çështje të krimin trans-nacional, edhe nëse është bërë në mënyrë jozyrtare. Ky lloj i komunikimit është zhvilluar në baza të rregullta. Për

shembull, përmes thirrjeve telefonike, ndërsa posta elektronike dhe format e tjera të komunikimit “zyrtar” nuk janë shfrytëzuar drejtpërdrejt mes dy institucioneve policore. Komunikimi zyrtar, megjithatë, shkon ose përmes INTERPOL-it/UNMIK-ut ose EULEX-it (Elshani 2016). Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit (ILECU) shërben si “kanal i dytë”. Njësia për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit është një projekt i nisur nga BE-ja për të krijuar një formë të zbatimit efektiv të ligjit ndërkombëtar në vendet e Ballkanit perëndimor në mënyrë që të mund të shkëmbejnë informata. Ajo është pika qendrore e kontaktit e Kosovës për bashkëpunim ndërkombëtar policor. Kjo do të thotë që “të gjitha” informatat sa i përket bashkëpunimit policor shkojnë përmes Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit, duke e përfshirë edhe atë të ZQK-së së UNMIK-ut dhe EULEX-it (Kursani 2015). Gjersa rrëfimet nga të dyja anët, së bashku me realitetin politik, sugjerojnë realizim të ngadalshëm të bashkëpunimit policor, megjithatë realiteti i sigurisë mund t’i shtyjë të dyja palët që t’i bashkojnë misionet edhe nëse kjo nuk bëhet përmes një platforme zyrtare dhe të organizuar. Kjo është e nevojshme për shkak të vështirësive aktuale në parandalimin e trafikimit dhe të krimeve të tjera.

## **Problemet kryesore: mungesa e demarkacionit dhe militarizimi i kufirit**

Janë dy probleme themelore në vijën kufitare mes të dyja vendeve. E para është procesi i demarkacionit me Serbinë. Kosova nuk ka marrëveshje për demarkacionin e kufirit me Serbinë. Përveç mungesës së realizimit të patrullimeve të përbashkëta mes dy vendeve, edhe kjo ka krijuar hapësirë për abuzim të forcës nga njëra ose nga pala tjetër. Në vitin 2012, dy zyrtarë të Policisë së Kosovës u arrestuan nga xhandarmëria serbe, të cilët po patrullonin në zonën e përgjegjesisë së Policisë së Kosovës në vijën kufitare me Serbinë (VOA 2012). Ka pasur një varg reagimesh mes dy vendeve dhe bashkësisë ndërkombëtare si rezultat i një veprimi të tillë. Kjo çështje mbetet problematike edhe kur kihet parasysh se nuk është realizuar ende procesi i de-

markacionit mes të dyja vendeve dhe lejon hapësirë për keqpërdorimin e zonës kufitare. Për më tepër, për shkak të statusit neutral të bashkësisë ndërkombëtare, procesi i demarkacionit me Serbinë nuk është bërë temë e bisedimeve mes të dyja vendeve, e as që është kusht i BE-së për procesin e anëtarësimit të Serbisë. Edhe pse institucionet e Kosovës e kanë ngritur këtë çështje gjatë kontaktit të tyre me institucionet e BE-s, tash për tash kjo e fundit duket se nuk ka një qasje të qartë sa i përket këtij problemi. Megjithatë, duke i pasur parasysh kontestet bilaterale mes gjashtë vendeve të Ballkanit perëndimor është bërë, megjithatë, pak përparim në drejtim të heqjes së tyre me qëllim të lehtësimit të procesit të anëtarësimit në BE. Për këtë qëllim, një prej rekomandimeve kryesore të procesit të Berlinit është krijimi i një kornize të përbashkët për zgjidhjen e kontesteve kufitare, e cila e bën më të lehtë shkëmbimin e praktikave më të mira dhe të ndihmës teknike për shënimin e kufirit (Dimitrov et al 2016).

Çështja e dytë është kontrolli i vijës kufitare. Që prej nënshkrimit të marrëveshjes teknike ushtarake në vitin 1999 mes KFOR-it dhe Serbisë, vija kufitare është monitoruar kryesisht prej ushtrisë në të dy anët e kufirit. Serbia e kontrollon vijën kufitare me Kosovën edhe me ushtri edhe me xhandarmëri (Guda 2016). E kontrollon kufirin me brigadën më të madh në kuadër të ushtrisë serbe, brigada e katërt e ushtrisë. Kjo brigadë është e pajisur rëndë dhe ka njësinë më të madhe të tankeve në kuadër të ushtrisë së Serbisë (Vojska Srbije 2016). Detyra kryesore e kësaj brigade është sigurimi i vijës kufitare prej 117 km (prej 382 km<sup>3</sup>) me Kosovën dhe kontrolli i zonës tokësore të sigurt prej 505 km<sup>2</sup> në pjesën jugore të Serbisë (Vojska Srbije 2016). Pjesa jugore e Serbisë banohet kryesisht me shqiptarë, dhe prania e ushtrisë së Serbisë në këtë pjesë të vendit, si dhe në kufi me Kosovën, paraqet ndjenjë të pasigurisë dhe të armiqtësisë, si dhe një kërcënim i drejtpërdrejtë për bashkësinë shqiptare. Vija kufitare me Kosovën në anën serbe, kontrollohet prej xhandarmërisë, të cilët janë në bashkërendim të vazhdueshëm me anëtarët e brigadës së katërt të ushtrisë (Vojska Srbije 2016).

Në anën e Kosovës, KFOR-i vazhdon ta ushtrojë mandatin e sigurimit të kufirit (zona e gjelbër) me Serbinë. KFOR-i është i pranishëm në Kosovë prej vitit 1999, qëllimi kryesor i të cilit ishte parandalimi i armiqtësisë,

krijimi i një mjedisi të sigurt dhe rendi e siguria publike, si dhe çështje të tjera që lidhen me sigurinë (NATO's role in Kosovo). KFOR-i aktualisht kontribuon në mbajtjen e një mjedisi të sigurt në Kosovë dhe në lirinë e lëvizjes për të gjithë. KFOR-i ia ka bartur përgjegjësitë policisë kufitare të Kosovës për kontrollin e kufirit me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Megjithatë, kjo përgjegjësi nuk është bartur ende te policia kufitare e Kosovës për kufirin Kosovë-Serbi. KFOR-i e kontrollon vijën kufitare me Serbinë për shkak se ende e konsideron me rrezikshmëri të lartë gjendjen mes Kosovës dhe Serbisë. Brigada shumëkombëshe - Lindje (MNBG-E) është përgjegjëse për vijën "e gjelbër", dhe përbëhet kryesisht prej trupave amerikane, si dhe prej trupave gjermane, hungareze, polake, rumune, dhe turke (NATO MNBG-E). Si me rastin e EULEX-it dhe të Ministrisë së Brendshme të Serbisë, NATO-ja dhe Ministria e Mbrojtjes e Serbisë e kanë themeluar zyrën ushtarake ndërlidhëse të NATO-s në Beograd në dhjetor të vitit 2006, e cila shërben si pikë kontakti mes Serbisë dhe NATO-s (KFOR-NATO). Është themeluar në kuadër të programit të partneritetit për paqe, dhe ka për synim t'i mbështet përpjekjet e Serbisë në reformat e sektorit të mbrojtjes. KFOR-i mban qëndrim neutral ndaj statusit të Kosovës, dhe mban takime të rregullta me ushtrinë e Serbisë, edhe pse autoritetet në Prishtinë e kundërshtojnë këtë fuqishëm. Një prej problemeve më shqetësuese ishte vizita e shpeshtë e gjeneral Lubisha Diković të KFOR-it në Prishtinë, i cili, sipas Qendrës për të Drejtën Humanitare, është përgjegjës për krimet e luftës në Kosovë (Dosije Dikovic 2012). Pas vizitës së gjeneral Dikovićit në shtabin qendror të KFOR-it në Prishtinë, ai u shpall person i padëshiruar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës (Rrokum 2016). Nga ai moment, takimet e rregullta mes KFOR-it dhe Serbisë mbahen në Serbi.

Zyrtarë të lartë brenda Policisë së Kosovës kanë deklaruar se mungesa e bashkëpunimit reflektohet në sigurinë kufitare meqë nuk mund të nisin veprimet e përbashkëta, të shkëmbejnë informata për veprimtaritë kriminale dhe problemet e sigurisë (Guda 2016). Policia e Kosovës është e pranishme, edhe pse në numër të kufizuar, në vijën kufitare me Serbinë, dhe kryesisht është e pranishme në pjesën jug-lindore të vijës kufitare. Janë ndërmarrë disa vlerësime të rrezikut me qëllim të kontrollimit të vijës kufitare me polici,

por me kufizime, pasi mandati ligjor për këtë është i rezervuar për KFOR-in, që bënë që të mos jetë e mundur ardhja deri te një marrëveshje zyrtare me Serbinë (Guda 2016). Në anën tjetër, pikat kufitare me Serbinë kontrollohen prej Policisë së Kosovës.

## Rekomandime

- Si njëra prej palëve kryesore, kur flasim për përcaktimin e marrëveshjeve mes Kosovës dhe Serbisë, BE-ja duhet ta merr rolin udhëheqës dhe të sigurohet që marrëveshjet të respektohen nga të dyja shtetet. Prandaj, BE-ja duhet të ketë rol themelor sa i përket zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të arritura mes të dyja palëve, ashtu që të parandalohet zvarritja e tyre e mëtejme. BE-ja duhet të përcaktojë një strategji të qartë sa i përket qasjes që do të përdoret për t'i zvogëluar kontestet mes të dyja shteteve, dhe të përcaktojë objektiva të prekshme në fushën e bashkëpunimit policor.
- Për ta siguruar rezultate dhe qasje proaktive sa i përket themelimit të bashkëpunimit policor mes Kosovës dhe Serbisë, BE-ja duhet ta kushtëzojë kriterin e integritetit dhe të anëtarësimit të të dyja vendeve në BE.
- Procesi i bisedimeve të Brukselit mes përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë duhet të jetë transparent me qëllim që të sigurohet legjitimiteti i tërë procesit. Procesi i demarkacionit të kufirit me Serbinë duhet të fillojë sa më parë. BE-ja duhet ta parashih marrëveshjen e demarkacionit mes Kosovës dhe Serbisë. Kjo do ta paraqiste zotimin e tyre për t'i tejkaluar me sukses kontestet kufitare dhe do ta lehtësonte bashkëpunimin kufitar.
- Duke e pasur parasysh mungesën e dukshme të vëmendjes politike për trajtimin e bashkëpunimit policor mes të dyja vendeve, institucionet e zbatimit të ligjit, dhe veçanërisht institucionet policore në të dyja vendet, duhet të vazhdojnë me komunikimin dhe bashkëpunimin e tyre të drejtpërdrejtë përmes zyrave të Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit (ILECU). Në ndërkohë, duhet të bëhet një marrëveshje e bashkëpunimit mes dy vendeve në fusha të caktuara të veprimtarisë kriminale me qëllim që të parandalohen krimet trans-nacionale të natyrës së përbashkët.
- Qeveria e Kosovës duhet ta hartojë një plan praktik të veprimit për ta nxitur politikën e jashtme të Kosovës lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe bilateral në fushën e policisë. Ky plan duhet të ketë një plan të hollësishëm për përmbushjen e qëllimeve kryesore sa i përket pozitës së saj ndërkombëtare dhe të ndërmarrjes së hapave drejt bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal në fushën e sigurisë dhe të bashkëpunimit bilateral policor.
- Si pala kryesore që e bart përgjegjësinë e bashkëpunimit të ministrive për themelimin e bashkëpunimit rajonal, zyra e kryeministrit të Kosovës duhet ta realizojë këtë mandat. Ajo duhet ta merr rolin udhëheqës për t'i udhëzuar ministrinë për rolin e tyre kur kemi të bëjmë me bashkëpunimin multilateral dhe bilateral në fushën e policisë. Ky veprim nuk duhet të lë hapësirë për vonesa, si dhe duhet të përjashtojë mundësinë e kryerjes së dyfishtë të punëve mes ministrive.
- Kosova duhet të llojë sa të mundet që të merr pjesë në nismat dhe takimet rajonale dhe ndërkombëtare. Kosova duhet të synojë që të informohet për rreziqet dhe kërcënimet kryesore rajonale, si dhe të punojë për krijimin e një rrjeti në këto platforma. Njohja me përfaqësuesit e vendeve të tjera nëpër ato takime mund ta lehtësojë përfshirjen e Kosovës në ato nisma, porse mund ta lehtësojë edhe bashkëpunimin me autoritetet serbe.
- Kosova duhet ta bëjë zyrtare bashkëpunimin policor edhe me vendet e tjera, të cilat e kanë njohur Kosovën shtetësinë e saj, me qëllim të shkëmbimit të informatave sa i përket rreziqeve dhe kërcënimeve të rajonit dhe më gjerë. Format e drejtpërdrejta të komunikimit mundësojnë marrjen e shpejtë të informatave në rastet e rreziqeve dhe kërcënimeve serioze.

## Bibliografia

### Intervistat:

1. Artan Duraku, shef i departamentit për politika të planifikimit, Ministria e Punëve të Jashtme, 31 mars 2016.
2. Carsten Twelmeier, këshilltar i lartë policor i PSSP-së, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), 31 mars 2016
3. Damijan Sedar, këshilltar i lartë politik, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë, 4 shkurt 2016
4. Fitim Mulolli, zyrtar politik, shef i departamentit të misionin, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), 24 shkurt 2016
5. Lulzim Mjeku, shef i departamentit për NATO dhe politika të sigurisë, Ministria e Punëve të Jashtme, 1 mars 2016
6. Oliver Hoffmann, këshilltar në EULEX i zëvendës-drejtorit të përgjithshëm, 17 qershor 2016
7. Shaban Guda, shef i departamentit të kufirit, Policia e Kosovës, 11 shkurt 2016
8. Veton Elshani, shef i Njësisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit (ILE-CU), 12 shkurt 2016

### Literatura:

- Action Plan for Chapter 24, linku: [http://www.mup.gov.rs/wps/wcm/connect/36e98096-9938-4aaf-b36c-e413bfbcac57/Treca\\_verzija\\_AP\\_27\\_03\\_2015.pdf?MOD=AJPERES&CVID=kTX-D4Ry](http://www.mup.gov.rs/wps/wcm/connect/36e98096-9938-4aaf-b36c-e413bfbcac57/Treca_verzija_AP_27_03_2015.pdf?MOD=AJPERES&CVID=kTX-D4Ry), (vizituar më 10 shtator 2016)
- Avdiu, Plator, (2015) *Departure to the EU Member States: causes and consequences of Kosovo's recent migration*, gjendet në: [http://www.qkss.org/repository/docs/Departure\\_to\\_EU\\_Member\\_States\\_204237.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Departure_to_EU_Member_States_204237.pdf) (vizituar më 12 prill 2016)
- Beha, A., 2015. Disputes over the 15-point agreement on normalization of relations between Kosovo and Serbia. *Nationalities Papers*, 43(1), pp.102-121.
- *Berlin demands Serbia aligns constitution with Brussels agreement* (2014), gjendet në: <http://www.constitutionnet.org/news/berlin-demands-serbia-aligns-constitution-brussels-agreement> (vizituar më 28 mars 2016).
- CFSP Report - Our priorities in 2016, linku: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-13026-2016-INIT/en/pdf>, (vizituar më 19 tetor 2016)
- Chapters of the acquis, European Neighborhood Policy and Enlargement, gjendet në: [http://ec.europa.eu/enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis/index_en.htm), (vizituar më 18 shtator 2016)
- *Constitution of the republic of Serbia* (no date), gjendet në: <http://www.ustavni.sud.rs/page/view/en-GB/235-100028/constitution> (vizituar më 31 mars 2016).
- Council of the European Union (2015) *Stabilisation and Association agreement between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo, of the other part*, gjendet në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf> (vizituar më 7 prill 2016).
- Dačić u Venecueli o Kosovu: Važno je što smo mi ovde, a oni ne, gjendet në: <http://www.telegraf.rs/vesti/politika/2360666-dacic-u-venecueli-o-kosovu-vazno-je-sto-smo-mi-ovde-a-oni-ne> (vizituar më 17 shtator 2016)
- Deda, I. and Qosaj-Mustafa, A. (2013) *The Analysis of the Implementation of the Technical Agreements between Kosovo and Serbia*. Gjendet në: [http://www.kipred.org/repository/docs/The\\_Analysis\\_of\\_the\\_Implementation\\_of\\_the\\_Technical\\_Agreements\\_Between\\_Kosovo\\_and\\_Serbia\\_189873.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/The_Analysis_of_the_Implementation_of_the_Technical_Agreements_Between_Kosovo_and_Serbia_189873.pdf) (vizituar më 31 mars 2016).
- Dejan Scepanovic, Serbia Opens Chapters 23 and 24 in its EU Accession Negotiations, gjendet në: <https://www.armedpolitics.com/3255/3255/>, (vizituar më 18 shtator 2016)
- Dimitrov, Nikola, Djolai, Marika and Wunsch, Natasha, (2016) *Removing obstacles to EU accession: Bilateral disputes in the Western Balkans*, Balkans in Europe Policy Advisory Group, linku: <http://balkanfund.org/wp-content/uploads/2015/08/BIEPAG-Policy-brief-web.pdf> (vizituar më 1 shtator 2016)
- Dosije Dikovic Ljubise, Humanitarian Law Center, 23 January 2013, Belgrade, gjendet në: <http://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2012/10/Ljubisa-Dikovic-Dosije-and-Prilog.pdf> (vizituar më 19 shtator 2016)

- Dr. Tomter, S., Bergsaker, E., Muja, I., Dale, T., and Kolstad, J., (2012) *Kosovo National Forest Inventory*, gjendet në <http://www.nfg.no/userfiles/file/Kosovo/Kosovo%20National%20Forest%20Inventory%202012.pdf>. (vizituar më 10 prill 2016)
- EULEX (2009) *Leading to an EU future - EULEX Kosovo*. Gjendet në: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0016.php> (vizituar më 30 mars 2016).
- European Commission (2015) *Kosovo 2015 Report*, 10.11.2015, gjendet në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf) (vizituar më 11 prill 2016)
- European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction, Europol (2016) *EU Drug Markets Report, In-depth Analysis*, gjendet në: <http://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/2373/TD0216072ENN.PDF> (vizituar më 11 prill)
- European Western Balkans, Serbian EU Accession Negotiations: Nothing Unexpected in Chapter 35, gjendet në: <https://europeanwesternbalkans.com/2015/12/28/serbian-eu-accession-negotiations-nothing-unexpected-in-chapter-35/> (vizituar më 18 shtator 2016)
- Greene, Jack R., *The Encyclopedia of Police Science*, Third Edition, Taylor and Francis Group, Routledge, 2007
- <http://www.vranje.org.rs/ogradu.php?id=0&oblast=brkopvoj>
- IBM Agreed Conclusion (2011), gjendet në: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement\\_0210\\_ibm.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/agreement_0210_ibm.pdf) (vizituar më 7 prill 2016)
- INTERPOL, National Central Bureaus, gjendet në: <http://www.interpol.int/About-INTERPOL/Structure-and-governance/National-Central-Bureaus>, (vizituar më 10 maj 2016)
- INTERPOL's Rules on the Processing of Data, INTERPOL Office of Legal Affairs, [II/IRPD/GA/2011(2014)]
- *Kosovo 2015 report* (2015). Gjendet në: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf) (vizituar më 27 mars 2016).
- Kursani, S. (2015) *POLICE COOPERATION BETWEEN KOSOVO AND SERBIA*. Gjendet në: [http://www.bezbednost.org/upload/document/police\\_cooperation\\_ks\\_eng\\_v3.pdf](http://www.bezbednost.org/upload/document/police_cooperation_ks_eng_v3.pdf) (vizituar më 25 mars 2016).
- Kursani, S., Haxholli, V. and Gjokolli, G. (2014) *Kosovo in regional context bilateral political relations 225564*. Gjendet në: [http://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo\\_in\\_Regional\\_Context\\_Bilateral\\_Political\\_Relations\\_225564.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo_in_Regional_Context_Bilateral_Political_Relations_225564.pdf) (vizituar më 22 mars 2016).
- Martino, F. (2014) *KOSOVO: BEYOND THE 'BRUSSELS AGREEMENT'*. Gjendet në: [http://193.205.23.8/sites/default/files/pubblicazioni/analisi\\_254\\_2014.pdf](http://193.205.23.8/sites/default/files/pubblicazioni/analisi_254_2014.pdf) (vizituar më 29 mars 2016).
- Memorandum of Understanding between the International Criminal Police Organization – Interpol and the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo on Co-operation in Crime Prevention and Criminal Justice
- Military Technical Agreement, between the International Security Force ("KFOR") and the Governments of the Federal Republic of Yugoslavia and the Republic of Serbia, link: <http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm> (vizituar më 10 shtator 2016)
- NATO's role in Kosovo, gjendet në: <http://jfcna-plex.nato.int/kfor/about-us/welcome-to-kfor/natos-role-in-kosovo>, (vizituar më 11 maj 2016)
- Policia serbe arreston dy policë të Kosovës, reagon Ministria e Punëve të Brendshme, linku <http://www.zeriamerikes.com/a/policia-serbe-arreston-dy-police-te-kosoves-reagon-ministria-e-puneve-te-brendshme-145390655/728598.html> (vizituar më 10 shtator 2016)
- Press release: EULEX Head of Mission Statement on Police Protocol, gjendet në: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/pressreleases/0016.php>, (vizituar më 11 maj 2016)
- Press Statement EU facilitated dialogue: Agreement on Regional Cooperation and IBM technical protocol, gjendet në: [http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_Data/docs/pressdata/EN/foraff/128138.pdf](http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/EN/foraff/128138.pdf), (vizituar më 11 maj 2016)
- *Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo Qeveria-Vlada-Government BRUSSELS AGREEMENTS IMPLEMENTATION STATE OF PLAY REPORT SUBMITTED TO THE EUROPEAN UNION / EUROPEAN EXTERNAL ACTION SERVICE BY THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA* (2015),

- gjendet në: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo\\_Report\\_on\\_state\\_of\\_play\\_in\\_Brussels\\_Dialogue\\_061015-signed.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo_Report_on_state_of_play_in_Brussels_Dialogue_061015-signed.pdf) (vizituar më 4 janar 2016).
- Screening report Serbia, Chapter 24 – Justice, freedom and security, 15.05.2014 linku: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/140729-screening-report-chapter-24-serbia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/140729-screening-report-chapter-24-serbia.pdf) (vizituar më 10 shtator 2016)
  - Serbia 2015 Report, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, link: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_serbia.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_serbia.pdf) (vizituar më 5 shtator 2016).
  - Serbian Assembly, Odluka o prihvatanju izvestaja o dosadasnjem procesu politickog i tehnickog dijaloga sa privremenim institucijama samouprave u Pristini uz posredovanje Evropske Unije, ukljuduci process implementacije postignutih dogovora, gjendet në: [http://www.parlament.gov.rs/upload/archive/files/cir/pdf/ostala\\_akta/2013/RS21-13.pdf](http://www.parlament.gov.rs/upload/archive/files/cir/pdf/ostala_akta/2013/RS21-13.pdf), (vizituar më 10 maj 2016)
  - Stabilization and Association Agreement between the European Communities and their Members States of the one part and the Republic of Serbia, of the other part, [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/serbia/key\\_document/saa\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/serbia/key_document/saa_en.pdf), (vizituar më 18 shtator 2016)
  - Stabilization and Association Agreement between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo\*, of the other Part, Brussels, 2 October 2015, linku: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf>, (vizituar më 10 maj 2016)
  - The draft of the Action Plan for Chapter 24 must be published, linku: <http://eukonvent.org/eng/the-draft-of-the-action-plan-for-chapter-24-must-be-published-by-ministry-of-internal-affairs/> (vizituar më 9 shtator 2016)
  - The Protocol: EULEX, MUP, and Kosovo, Report No. 9, Helsinki Committee for Human Rights in Serbia, August/September 2009
  - Vlerësimi i Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar – SOCTA 2014 – 2014, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, 2016, linku: [http://www.kosovopolice.com/repository/docs/VLER%C3%8BSIMI\\_I\\_K%C3%8BRRC%C3%8BNIMIT\\_NGA\\_KRIMET\\_E\\_R%C3%8BNDA\\_DHE\\_KRIMI\\_I\\_ORGANIZUAR\\_%E2%80%93\\_SOC-TA,\\_2014-2015.pdf](http://www.kosovopolice.com/repository/docs/VLER%C3%8BSIMI_I_K%C3%8BRRC%C3%8BNIMIT_NGA_KRIMET_E_R%C3%8BNDA_DHE_KRIMI_I_ORGANIZUAR_%E2%80%93_SOC-TA,_2014-2015.pdf), (vizituar më 15 shtator 2016)
  - Vojska Srbije, *Cetvrta Brigada KOV*, linku: <http://www.vs.rs/index.php?content=568448a2-f733-102b-bdc2-a0672172d7df>, last (vizituar më 10 prill 2016)
  - Vučić i Dačić na Generalnoj skupštini UN u Njujorku, gjendet në: <http://www.politika.rs/sr/clanak/363864/Vucic-i-Dacic-na-Generalnoj-skupstini-UN-u-Njujorku> (vizituar më 19 shtator 2016)
  - Maxhuni në Serbi pritet si drejtor i policisë së “krahinës së Kosovës”, gjendet në: <http://kohanet/?id=27&l=48203> (vizituar më 19 shtator 2016)
  - Mbas Seselj’it, i ndalohet hymja në Kosovë edhe gjeneralit Dikovic (DOKUMENT), Rrokum, gjendet në: <http://www.rrokum.tv/lajme/mbas-seselj-it-ndalohet-hymja-ne-kosove-edhe-gjeneral-it-dikovic-dokument/> (vizituar më 15 prill 2016)
  - Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Ministria Tahiri: Pikë kalimi i ri kufitar në Kapinë e Sforcës afron shqiptarët e Luginës së Preshevës me Kosovën, gjendet në: <http://kryeministri-ks.net/?page=1,9,6256>, (vizituar më 29 tetor 2016)



Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.74(496.51):(497.11)

Kryeziu, Sofije

Pa rrugëdalje ? : vlerësim i bashkëpunimit policor në mes Kosovës dhe Serbisë /  
Sofije Kryeziu. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë,  
2016. – 18 f. : ilustr. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-679-50-3**

---

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

ISBN 978-9951-679-50-3



9 789951 679503